

VENDIM
Nr. 150, datë 28.4.2023

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “KURUM INTERNATIONAL” SHA, PËR
MODIFIKIMIN E LICENCËS NR. 213, SERIA PM13P, PËR PRODHIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC-i “SHKOPET”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 13 dhe 15 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.4.2023, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, nr. 133/5 prot., datë 27.4.2023, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Kurum International” sh.a. për modifikimin e licencës nr. 213, seria PM13P, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-i “Shkopet”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 56, datë 24.2.2023, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-i “Shkopet”, i shoqërisë “Kurum International” sh.a., nga 24 mw në 28 mw.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 28.2.2023 dhe 29.2.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 29.3.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresën nr. 133/3 prot., datë 3.3.2023, ERE i është drejtuar shoqërisë, duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 133/4 prot., datë 24.4.2023.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga analizimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria “Kurum International” sh.a. ka plotësuar dokumentacionin si vijon:

Neni 15, “Modifikimi i licencës”, pika 4, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”: plotësuar.

- Leja e rinovuar për përdorimin e burimit ujqor për HEC “Shkopet” ka afat vlefshmërie 5 (pesë) vjet deri më datë 2.3.2025. Në këto rrethana vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë “Kurum International” sh.a. që të depozitojë në ERE lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujqor për prodhim hidroenergjie nga HEC-i “Shkopet”, brenda datës 2.3.2025.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të modifikojë licencën nr. 213, seria PM13P, miratuar me vendimin nr. 132, datë 6.12.2011, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe transferuar me vendimin nr. 126, datë 28.10.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, tek shoqëria “Kurum International” sh.a., për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-i “Shkopet”, si më poshtë:

Ishte: kapaciteti i instaluar 24 mw.

Bëhet: kapaciteti i instaluar 28 mw.

2. Në përmbajtjen e licencës nr. 213, seria PM13P, të pasqyrohen ndryshimet respektive në përputhje me rritjen e kapacitetit të instaluar të HEC-it “Shkopet”.

3. Shoqëria “Kurum International” sh.a. duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujqor për prodhim hidroenergjie nga HEC-i “Shkopet”, brenda datës 2.3.2025.

4. Ky vendim është objekt rishikimi në varësi të plotësimit/mosplotësimit nga ana e shoqërisë të kushtit të vendosur në pikën 3 të këtij vendimi.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Kurum International” sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe shoqërinë “Operatori Sistemit Transmetimit” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti